



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Janar-Prill, 2022)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale	3
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	11
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	Error! Bookmark not defined.
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	26
Analiza e risqeve.....	29
Regjistrat statistikorë	30



Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Janar-Prill, 2022, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të PSZ-së, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, dhe përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi ecurinë 4 - mujore të treguesve strategjikë si matës afatshkurtër të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të objektivave strategjikë 2022-2026, si dhe një informacion më të detajuar të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë për vitin 2022. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të katër fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi dhe publikimi dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat. Gjithashtu, për çdo aktivitet përcaktohet niveli i të dhënave si dhe përputhshmëria me Eurostat. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë dhe aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore si dhe aktivitetet e porealizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtoria Përgjithshme i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.

Progres-Raporti Janar-Prill, 2022

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2022, tre agjencitë statistikore si INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 në zbatim të masave të parashikuara për realizimin e objektivave strategjikë të SKS 2022-2026 si dhe në zbatim të Planit 2022 të PSZ-së



Indikatorët e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimore 2022-2026

Duke qenë se në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 janë përfshirë Objektivat Zhvillimore Strategjik, Sistemit Kombëtar Statistikor i lind detyrimi i raportimit në nivel 4 mujor mbi zbatimin e masave të parashikuara për zbatimin e këtyre objektivave, performanca e të cilit matet nëpërmjet vlerave të treguesve respektivë.

Më poshtë paraqitet tabela me vlerat e treguesve për periudhën Janar-Prill, 2022, në një qasje krahasimore me vlerat e pritshme si synim për vitin 2022.

Ecuria 4 mujore e treguesve strategjikë Janar-Prill, 2022

Objektivi	Indikatori	Vlera për periudhën Janar-Prill, 2022	Target line 2022
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit Evropian	1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafuara me acquis (Sipas PKIE)	1	1
	1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti <i>Peer Review 2018</i>), të zbatuara (në %)	83%	85%
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	2.2 Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	1,352,655	3,614,573
	2.6 Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel minimal vendor	3	11
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare	3.2 Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	22	40
Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	4	4
	4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga	3	12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

	INSTAT		
Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat përdoren software	76 aktivitete, në 4 prej të cilëve janë përdorur open source software (psh gjuha R)	96
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur	6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetat ditore kryesore ose në televizione	4622	3000

Nga tabela e mësipërme vihet re një trend pozitiv i performancës së Sistemit në katërmujorin referencë në drejtim të realizimit të objektivave strategjike dhe realizimit të pritshmërive të parashikuara për vitin 2022 apo dhe tejkalim i pritshmërive si psh lidhur me treguesin e vizibilitetit të produkteve të SKS në media.

Ndërkohë në seksionin e mëposhtëm paraqitet në mënyrë të përmbledhur ecuria e realizimit të Planit Vjetor të PSZ 2022, zbatimi i të cilit kontribuon në mënyrë direkte në zbatimin e objektivave strategjike të cilëve i dedikohet realizimi i aktiviteteve statistikore sipas katër fushave kryesore, lidhje e cila siguron zbatimin e strategjisë jo vetëm në nivel makro, por edhe në nivel operacional mikro si ‘platforma’ kryesore në të cilën mbështetet veprimtaria prodhuese statistikore e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Zbatimi i Planit Vjetor të PSZ 2022

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2022, janë parashikuar 76 aktivitete për prodhimin e 115 produkteve statistikore.

Ndarja sipas Agjencive Statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: përgjegjës për 65 aktivitete statistikore në funksion të prodhimit të 94 produkteve statistikore.

Banka e Shqipërisë: përgjegjës për 9 aktivitete statistikore në funksion të prodhimit të 18 produkteve statistikore

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: përgjegjës për 2 aktivitete statistikore në funksion të prodhimit të 3 produkteve statistikore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rezultatet për 4-mujorin sipas fazave të prodhimit statistikor, janë si më poshtë:

- *Grumbullimi i të dhënave:*
 - Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 113 produkte statistikore
 - Grumbulluar të dhënat në kohë për 112 produkte statistikore
 - 37 vrojtme: 28 PAPI; 5 CAPI, 2 CATI+CAWI 2 CATI;
 - 50 burime administrative: 26 mikro; 22 makro; 2 kombinuar;
 - 26 burime të kombinuara: 14 mikro; 12 kombinuar;
 - Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për 1 produkt statistikor.

 - *Përpunimi i të dhënave:*
 - Planifikuar përpunimi i të dhënave për 109 produkte statistikore;
 - Përpunuar të dhënat në kohë për 109 produkte statistikore.

 - *Publikimi i të dhënave*
 - Planifikuar realizimi i 61 Publikimeve statistikore;
 - Realizuar 59 publikime statistikore;
 - Nuk janë realizuar në kohë 2 publikime statistikore.

 - *Niveli gjeografik i të dhënave:*
 - Për 61 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel vendi;
 - Për 1 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel rajoni;
 - Për 4 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel qarku;
 - Për 3 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel bashkie;

 - *Transmetimi i të dhënave në Eurostat*
 - Janë transmetuar të dhënat për 72 produkte statistikore
- Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat rezultojn:
- 3 aktivitete plotësisht të përputhshme
 - 13 aktivitete me nivel të lartë përputhshmërie;
 - 38 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie;
 - 6 aktivitete me nivel të ulët përputhshmërie.
 - 12 aktivitete nuk është vlerësuar niveli i përputhshmërisë

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 4 fazave: grumbullim, përpunim, publikim, transmetim të dhënash.



Fusha statistikore 1: Statistikat Sociale dhe Demografike

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimin, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Për këtë fushë statistikore, janë 19 aktivitete që kanë produkt në një/të gjitha fazat e prodhimit statistikor në funksion të realizimit të 23 produkteve statistikore.

1. Grumbullimi i të dhënave:


- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 20 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 20 produkteve të mëposhtme statistikore:**
 - ✓ Statistikat e Popullsisë
 - ✓ Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar
 - ✓ Statistikat Vitale T4, 2021
 - ✓ Statistikat Vitale T1, 2022
 - ✓ Statistikat gjinore
 - ✓ Statistikat nga anketa tremujore e forcave të punës për T4, 2021
 - ✓ Statistikat nga të dhënat administrative të tregut të punës, T4, 2021
 - ✓ Statistikat të Strukturës së Kostos së Punës
 - ✓ Statistikat nga të dhëna administrative mbi pagat, T4, 2021
 - ✓ Statistika të regjistrimeve në arsim
 - ✓ Statistikat e shkaqeve të vdekjeve
 - ✓ Statistikat nga Anketa e Buxhetit të Familjes, 2021
 - ✓ Statistikat e Anketës së nivelit të Jetesës, SILC 2022
 - ✓ Statistikat nga të dhënat administrative të mbrojtjes sociale, T4, 2021
 - ✓ Statistikat mbi ESSPROS
 - ✓ Statistikat mbi veprat penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur
 - ✓ Statistikat mbi të dënuarit
 - ✓ Statistikat e Kulturës
 - ✓ Statistika të Kulturës nga Anketat Sociale në INSTAT
 - ✓ Statistika të Kulturës nga Anketat Ekonomike në INSTAT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Për 6 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimeve, ku në 4 vrojtim është përdorur metoda CAPI, 2 vrojtime është përdorur metoda e kombinuar (CAPI + CATI).
- Për 9 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative, ku për 4 nga këto burime të dhënat janë mikro dhe për 5 produkte të dhënat janë makro.
- Për 5 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime të Kombinuar (Vrojtim+Burim administrative).

Grafiku 1.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



2. Përpunimi i të dhënave


- **Planifikuar për tu përpunuar të dhënat për 20 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 20 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 - ✓ Statistikat e Popullsisë
 - ✓ Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar
 - ✓ Statistikat Vitale T4, 2021
 - ✓ Statistikat Vitale T1, 2022
 - ✓ Statistikat nga anketa tremujore e forcave të punës për T4, 2021
 - ✓ Statistikat nga të dhënat administrative të tregut të punës, T4, 2021
 - ✓ Statitikat të Strukturës së Kostos së Punës
 - ✓ Statistikat nga të dhëna administrative mbi pagat, T4, 2021
 - ✓ Statistika të regjistrimeve në arsim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Statistika të diplomimeve në arsim
- ✓ Shkaqet e vdekjeve
- ✓ Statistikat nga Anketa e Buxhetit të Familjes, 2021
- ✓ Statistikat e Anketës së nivelit të Jetesës, SILC 2021
- ✓ Statistikat nga të dhënat administrative të mbrojtjes sociale, T4, 2021
- ✓ Statistikat mbi ESSPROS
- ✓ Statistikat mbi veprat penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur
- ✓ Statistikat mbi të dënuarit
- ✓ Statistikat e Kulturës
- ✓ Statistika të Kulturës nga Anketat Sociale në INSTAT
- ✓ Statistika të Kulturës nga Anketat Ekonomike në INSTAT

Grafiku 1.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar publikimi i të dhënave për 11 produkte statistikore**
- **Realizuar 9 publikimet statistikore të mëposhtme:**
 - ✓ Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2022
 - ✓ Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2022
 - ✓ Treguesit demografik, T4-2021
 - ✓ Treguesit demografik, T1-2022
 - ✓ Tregu i punës
 - ✓ Tregu i punës (administrative)




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Pagat
- ✓ Rregjistrimet në Arsim 2021
- ✓ Ndihma Ekonomike
- Për 7 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel vendi
- Për 3 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel qarku

➤ **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për produktet e mëposhtme:**

- Vepra penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të burgosur
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Publikimi i të dhënave mbi “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale” për vitin 2021 është shtyrë me 5 ditë, për shkak të vonesës në verifikim të dhënash me institucionet përgjegjëse.
- Të dënuar
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Publikimi i të dhënave mbi “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale” për vitin 2021 është shtyrë me 5 ditë, për shkak të vonesës në verifikim të dhënash me institucionet përgjegjëse.

Grafiku 1.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Sociale dhe Demografike



- Janë transmetuar:
- ✓ Statistikat e Forcave të Punës
- **Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat kemi:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 5 aktivitete për të cilat nuk është vlerësuar niveli i përputhshmërisë
- 2 aktivitete me nivel të ulët
- 8 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie
- 1 aktivitet me nivel të lartë përputhshmërie
- 1 aktivitet në përputhshmëri të plotë

Aktivitetet e Censit të Popullsisë dhe Banesave

Gjatë periudhës Janar - Prill, 2022, ecuria e aktiviteteve në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave është si vijon:

Komunikimi i Censit:

- Janë kryer takime informuese me Kryetarët e Bashkive të vendit lidhur me rëndësinë e Censit si edhe nevojat për mbështetje.
- Është mbajtur i informuar KQC lidhur me ecurinë e procesit përgatitor të Censit.
- Është kryer aktiviteti "Censi në shkollë" për sensibilizimin e nxënësve të disa prej shkollave 9 vjeçare

Metodologjia e Censit, pyetësorët dhe sigurimi i cilësisë:

- Pyetësorët e Cens-it janë përditësuar sipas gjetjeve të pilot cens dhe janë përkthyer zyrtarisht, po riestohen në Testin 4
- Bazuar në gjetjet e pilotit ka filluar puna përgatitore për përgatitjen e Testit të katërt
- Manuali i anketuesit ka përfunduar në anglisht duke refektuar gjetjet e pilot Cens-it dhe ndryshimet në pyetësor dhe do të dërgohet për përkthim në shqip. Manuali i kontrollorit është duke u finalizuar
- Të dhënat e pilot cens janë përpunuar dhe analizuar duke përpiluar më pas dhe gjetjet e pilot cens (ku përfshihen të gjitha problematikat e hasura nga ana metodologjike)
- Aplikacioni i mbledhjes së të dhënave të Cens-it, është përditësuar duke reflektuar të gjitha ndryshimet e pilot cens dhe po testohen në testin e katërt.
- Janë evidentuar gjetjet e pilotit të dytë sipas të gjitha njësive të Censit
- Aktivitetet e APC janë kryer sipas planit. Pas anketës pilot të pas Cens-it, u krye analiza e të dhënave dhe u përgatitën gjetjet
- Janë përgatitur termat e referencës për stafin në terren
- Aplikacioni i mbledhjes së të dhënave të anketës pilot të pas Cens-it, është përditësuar duke reflektuar të gjitha ndryshimet dhe procesi i mbledhjes së të dhënave në terren ka shkuar shumë mirë
- Të dhënat e APC u procesuan dhe analizuan me kujdes ku u përgatit raporti i detajuar i gjetjeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Me suportin e ekspertit përkatës u përgatitën të gjitha skriptet e match-it të të dhënave të pilot cens dhe anketës pilot të pas cens.

Gjeoinformacioni dhe baza e të dhënave për ndërtesat / banesat:

- Aktiviteti i përditësimit të hartave do të realizohet në periudhën Qershor - Korrik 2022, në mënyrë që të kemi informacion sa më të përditësuar për procesin e numërimit.
- Janë rishikuar kufijtë e Zonave të Censit të cilët do të përditësohen
- Ka filluar puna për përcaktimin e metodave të përgatitjes së hartave dixhitale
- Ka vazhduar puna lidhur me krijimin e një modeli të përshatshëm për regjistrin statistikor të Ndërtesave dhe Banesave

Puna dhe numërimi në terren i Censit:

- Është punuar për vlerësimin e ambjenteve të nevojshme për Censin

Tabulimi, analizimi dhe shpërndarja e rezultateve të Censit:

- Janë përgatitur të gjitha kontrollet logjike të cilat janë reflektuar në aplikacionin e mbledhjes së të dhënave në terren
- Plani i tabulimeve është drejt finalizimit, gjatë muajit prill u krye misioni për planin e tabulimeve dhe përgatitjen e skripteve për tabulimin e të dhënave (të planifikuar në planin e tabulimeve)
- Janë përgatitur të gjitha skriptet për derivimin e variablave sipas planit të tabulimeve

Teknologjia e informacionit dhe përpunimi i të dhënave:

- Bazuar në gjetjet e pilotit ka filluar puna përgatitore për përgatitjen e Testit të katërt
- Bazuar në gjetjet e pilotit është punuar për përshtatjen e aplikacionit CAPI
- Bazuar në gjetjet e pilotit është punuar për përshtatjen e aplikacionit të Monitorimit
- Në proces prokurimi për Hardware & Software për punën në terren
- Ka filluar puna, bazuar në të dhënat e pilotit të dytë.
- Mbështetje TI për pilot APC

Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Për këtë fushë statistikore, janë 15 aktivitete që kanë produkt në një/të gjitha fazat e prodhimit statistikor në funksion të realizimit të 23 produkteve statistikore.

- INSTAT është përgjegjës për 10 aktivitete statistikore - për 11 produkte statistikore
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 3 aktivitete statistikore - për 9 produkte statistikore
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për 2 aktivitete statistikore - për 3 produkte statistikore

1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 24 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 23 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 - ✓ PBB vjetore me metodën e Prodhimit, 2019 F dhe 2020 gjysëm final
 - ✓ PBB vjetore me metodën e Shpenzimeve 2019 F dhe 2020 gjysëm final
 - ✓ PBB tremujore me metodën e Prodhimit, T4, 2021
 - ✓ PBB tremujore me metodën e Shpenzimeve, T4, 2021
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M12, 2021
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M1, 2022
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M2, 2022
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M3, 2022
 - ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M12, 2021
 - ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M1, 2022
 - ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M2, 2022
 - ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M3, 2022
 - ✓ Bilanci Sektorial dhe paraqitja Mon. T4, 2021
 - ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFMS2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
 - ✓ Statistikat e Borxhit, T4, 2021
 - ✓ Statistikat e Borxhit, T1, 2022
 - ✓ Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve
 - ✓ Statistikat e Produkteve Industriale
 - ✓ Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T4, 2021
 - ✓ Statistikat e lejeve të ndërtimit, T4, 2021
 - ✓ Statistikat e lejeve të ndërtimit, T1, 2022
 - ✓ Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve
 - ✓ Regjistri i Njësive Lokale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për produktin e mëposhtëm


- “Statistikat e lejeve të ndërtimit, T1, 2022” për shkak të mungesës së pyetësorve.

- Për 3 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit, ku në 2 vrojtime është përdorur metoda CATI, ndërsa në 1 vrojtim është përdorur metoda PAPI.

-Për 11 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burimi administrativ, ku për 8 produkte të dhënat janë mikro, për 2 produkt të dhënat janë makro, ndërsa për 1 produkt dhënat janë të kombinuara (mikro+makro)

-Për 9 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara, ku për 5 produkte të dhënat janë mikro dhe për 4 produkte të dhënat janë të kombinuara (mikro+makro).

Grafiku 2.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Ekonomike



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar përpunimi i të dhënave për 23 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 23 produkteteve statistikore të mëposhtme:**
 - ✓ PBB vjetore me metodën e Prodhimit, 2019 F dhe 2020 gjysëm final
 - ✓ PBB vjetore me metodën e Shpenzimeve 2019 F dhe 2020 gjysëm final
 - ✓ PBB tremujore me metodën e Prodhimit, T4, 2021
 - ✓ PBB tremujore me metodën e Shpenzimeve, T4, 2021
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M12, 2021
 - ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M1, 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M2, 2022
- ✓ Statistikat Monetare dhe Financiare, M3, 2022
- ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M12, 2021
- ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M1, 2022
- ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M2, 2022
- ✓ Statistikat e Normave të Interesit, M3, 2022
- ✓ Bilanci Sekterial dhe paraqitja Monetare. T4, 2021
- ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
- ✓ Statistikat e Borxhit, T4, 2021
- ✓ Statistikat e Borxhit, T1, 2022
- ✓ Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve
- ✓ Statistikat e Produkteve Industriale
- ✓ Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T4, 2021
- ✓ Statistikat e lejeve të ndërtimit, T4, 2021
- ✓ Statistikat e lejeve të ndërtimit, T1, 2022
- ✓ Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve
- ✓ Regjistri i Njësive Lokale

Grafiku 2.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Ekonomike



3. Publikimi i të dhënave

- Planifikuar për tu publikuar të dhënat për 19 produkte statistikore
- Realizuar 19 publikime statistikore si më poshtë:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Produkti i Brendshëm Bruto, Final 2019 - Gjysmë final 2020
- Produkti i Brendshëm Bruto, Final 2019 - Gjysmë final 2020
- Produkti i Brendshëm Bruto, T4 – 2021
- Produkti i Brendshëm Bruto, T4 – 2021
- Treguesit monetar dhe financiarë
- Treguesit monetar dhe financiarë
- Treguesit monetar dhe financiarë
- Treguesit monetar dhe financiarë
- Statistikat e Normave të Interesit, M12, 2021
- Statistikat e Normave të Interesit, M1, 2022
- Statistikat e Normave të Interesit, M2, 2022
- Statistikat e Normave të Interesit, M3, 2022
- Bilanci Sekt. dhe paraqitja Mon. T4, 2021
- Statistikat fiskale vjetore
- Treguesit e borxhit
- Treguesit e borxhit
- Rezultatet finale të Anketës Strukture të Ndërmarrjeve, 2020
- Statistikat-afatshkurtra: Të mirat/ Shërbime/ Tregti me pakicë
- Lejet e ndërtimit Tremujori IV, 2021

- Për 17 aktivitete statistikore të dhënat janë në nivel vendi
- Për 1 aktivitet statistikor të dhënat janë në nivel qarku
- Për 1 aktivitet statistikor të dhënat janë në nivel bashkie

Grafiku 2.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Ekonomike



4. Transmetimi

✓ Duhet transmetuar të dhënat në Eurostat për 7 produkte statistikore

✓ Janë transmetuar:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Statistikat e PBB-së vjetore me metodën e Prodhimit
- ✓ Statistikat e PBB-së vjetore me metodën e Shpenzimeve
- ✓ Statistikat e PBB-së tremujore me metodën e prodhimit, me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe të përshtatura sezonalisht për T4, 2021
- ✓ Statistikat e PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht për T4, 2021
- ✓ Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T4, 2021
- ✓ Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor
- ✓ Statistikat e Lejeve të Ndërtimit. T4, 2021

➤ **Përsa i përket nivelit të përputhshmërisë me Eurostat kemi:**

- 3 aktivitete të pavlerësuara
- 12 aktivitete me nivel të mesëm përputhshmërie
- 2 aktivitete me nivel të lartë përputhshmërie

Grafiku 2.4 Përmbledhja e fazës së transmetimit për fushën: Statistikat Ekonomike



Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Për këtë fushë statistikore janë 41 aktivitete që kanë produkt në këtë katërmujor dhe këto aktivitete konvertohen në 68 produkte statistikore për të cilat:

INSTAT është përgjegjës për 35 aktivitete - 59 produkte statistikore

Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 6 aktivitete - 9 produkte statistikore

1. Grumbullimi i të dhënave

➤ Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 68 produkte statistikore

➤ Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 68 produkteve statistikore të mëposhtme:

- ✓ Statistikat e produkteve bimore të gjeneruara nga Vrojtimi Vjetor në Bujqësi
- ✓ Statistikat e produkteve bimore nga të dhënat administrative
- ✓ Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga Vrojtimi Vjetor në Bujqësi
- ✓ Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga të dhënat administrative
